VENDIM
Nr.242, datë 21.4.2005

PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË POLITLKAVE TË ZHVILLIMIT, PËR PROGRAMIN E MENAXHIMIT TË INTEGRUAR DHE TË PASTRIMIT TË ZONËS BREGDETARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e dokumentit të politikave të zhvillimit, për programin e menaxhimit të integruar dhe të pastrimit të zonës bregdetare, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëhere.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

LËNDA: DOKUMENTI I POLiTIKAVE TË ZHVILLIMIT, PËR PROGRAMIN E MENAXHIMIT TË INTEGRUAR DHE PASTRIMIN E ZONËS BREGDETARE

1. Hyrje

Ky dokument është hartuar nga qeveria shqiptare në lidhje me Programin e Manaxhimit të Integruar dhe Pastrimin e Zonës Bregdetare (më poshtë: Programi) dhe ka për qëllim zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit në zonën bregdetare të vendit.

Programi është hartuar si një Program Huadhënës i Adaptueshëm i cili do të zbatohet gjatë një periudhe 7-vjecare, faza e I-rë e të cilit është planifikuar për periudhën shtator 2005 deri në gusht 2009 dhe faza e II-të për periudhën janar 2009 - gusht 2012. Faza e dytë do të ndërtohet mbi rezultatet fillestare të fazës së I-rë nëpërmjet mbështetjes së iniciativave të zhvillimit dhe investimeve të mëtejshme specifike.

Programi total pritet të kushtojë 66.5 milion USD.

Qeveria shqiptare është e angazhuar të punojë në bashkëpunim me donatorë bilateralë e multirateralë për realizimin e këtij programi dhe në muajin mars të këtij viti, kjo e fundit ftoi donatorët që operojnë në Shqipëri dhe jashtë saj për të siguruar një financim tjetër për këtë program.

2. Objektivi i programit.

Objektivi i Përgjithshëm i Programit, është të mbrojë burimet natyrore dhe pasuritë kulturore të bregdetit të Shqipërisë dhe të promovojë menaxhimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të tyre.

Objektivi i programit do të arrihet nëpëmjet:

1.Krijimit të kuadrit institucional dhe politik të menaxhimit të integruar të zonës bregdetare dhe forcimit të kapacitetit më të gjerë rregullator në nivelin qëndror, rajonal dhe lokal për mbrojtjen e burimeve natyrore bregdetare dhe detare.

2.Rritjes së aksesit në shërbimet bazë e shoqëruar kjo me përmirësimin e cilësisë së jetës dhe tërheqjes ndaj zonave bregdetare.

3.Zbatimin e nënprojekteve që kanë si synim promovimin e zhvillimit të qendrueshëm të sektorit të turizmit.

3.Fazat e programit

Programi do të jetë i ndarë në fazat e mëposhtme:

Faza I. Faza e I-rë e programit synon formulimin dhe zbatimin e politikave që mbështesin menaxhimin e integruar të zonës bregdetare për reduktimin e degradimit bregdetar.

Faza e I-rë , do të jetë përmirësimi i kuadrit ligjor, politikave rregullatore dhe qeverisjes së zonës bregdetare, promovimi i planifikimit të integruar të zonës bregdetare; nxitja e mbështetjes së komunitetit për menaxhimin e qendrueshëm të zonës bregdetare dhe realizimi i investimeve të infrastrukturës bazë që promovon zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit në vend.

Kjo fazë do të kontribuojë në zhvillimin e turizmit të qendrueshëm, në përmirësimin e kushteve mjedisore, përmirësimin e cilësisë së jetës, ruajtjen dhe rijetëzimin e trashëgimisë kulturore dhe arkitekturore të komuniteteve bregdetare jugore të synuara.

Gjithashtu kjo fazë do të synojë reduktimin e rreziqeve për shëndetin e njerëzve në komunitetet përreth zonës së nxehtë industriale të Porto Romanos.

Faza e II. Faza e II-të e programit do të zhvillojë më tej kapacitetin institucional, ligjor dhe rregullator të menaxhimit të integruar dhe do të mbështesë zhvillimin e qendrueshëm të turizmit në mënyrë që ai të shërbejë si një mjet i rritjes ekonomike.

Duke u mbështetur në arritjet dhe realizimet e fazës së I-rë dhe mbi mësimet e nxjerra nga ajo, faza e II-të e programit do të shtrijë në mënyrë të konsiderueshme mbështetjen e tij për infrastrukturën bregdetare, menaxhimin e zonave të mbrojtura, ruajtjen/rehabilitimin e eko-sistemeve kritike detare dhe bregdetare, pastrimin dhe rehabilitimin e zonave të ndotura, si dhe zgjerimin e zhvillimit të qendrueshëm të turizmit komunitar.

Në të njëjtën kohë kjo fazë do të promovojë edhe partneritetet publike-private. Fusha të veçanta mbështetjeje në kuadrin e fazës së II-të do të përcaktohen gjatë fazës së I-rë.

Faza e Il-të do të ndërthuret me projektin e financuar nga GEF (Global Environment Facility) në kuadrin e Fondit të Investimit të Partneritetit të Detrave Mesdhe/Adriatik.

4. Objektivat e zhvillimit të programit, faza e I-rë.

Objektivi i zhvillimit të programit gjatë fazës së I-rë është të krijojë dhe fillojë ndjekjen e një
metode menaxhimi të integruar të zonës bregdetare për të reduktuar degradimin e kësaj zone nëpërmjet:

1. Forcimit të politikave rregullatore dhe qeverisjes së zonës bregdetare, përdorimit të tokës
dhe kapacitetit planifikues dhe institucional në nivel qendror, rajonal dhe lokal;

2. Fillimit të investimeve të fokusuara, bashkiake dhe komunitare në bregdetin jugor, për të përmirësuar kushtet mjedisore, burimet kulturore dhe për të inkurajuar mbështetjen e komunitetit për
menaxhimin e qëndrueshëm të zonës bregdetare;

3. Reduktimit të ndotjes së dheut dhe ujërave nëntokësore në ish/uzinën kimike të Porto Romanos.

5. Politikat e zhvillimit.

Qeveria shqiptare është e angazhuar të zbatojë principet kryesore të Menaxhimit të Integruar të Zonës Bregdetare:

1. Balancimin e përfitimeve të zhvillimit ekonomik, ruajtjes, mbrojtjes dhe rijetëzimit të zonës bregdetare si dhe

2. Balancimin ndërmjet aksesit publik e privat dhe shfrytëzimit të zonës bregdetare.

Gjithashtu qeveria ka marrë përsipër të ngrijë përkohësisht aprovimin e studimeve pjesore dhe dhënien e lejeve të ndërtimit në zonat turistike të bregdetit të jugut, deri në hartimin dhe miratimin e studimit të zhvillimit të bregdetit të jugut nga ana e Këshillit të Rregullimit të Territorit të Republikës (KRRTRSH). Studimet lokale do të përgatiten në përputhje me parametrat e
vendosura në studim.

Qeveria do të ndjekë një metodë pjesëmarrjeje në zbatimin e programit, duke përfshirë grupet e interesuara dhe komunitetin e gjerë në nivel qendror, rajonal, bashkiak dhe komune.

6. Treguesit e ecurisë për fazën e I-rë

Treguesit kyç për arritjen e objektivave të fazës së I-rë do të jenë si më poshtë:

- Të ketë përfunduar procesi i hartimit dhe aprovimit të studimit, nga Këshilli i Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë (KRRTRSH).

- Zhvillimi i infrastrukturës publike në zonën bregdetare jugore të jetë në përputhje me studimin.

- Planifikimi i përdorimit të tokës dhe dhënia e lejeve të ndërtimit, të jenë në përputhje me parametrat dhe masat e caktuara në studim.

- Ndërtesat e reja në zonën bregdetare jugore, të mos shqetësojnë vlerat dhe karakteristikat hapësinore ekzistuese.

- Planifikimi fizik lokal, rajonal dhe kombëtar dhe investimet, të jenë në përputhje me parimet dhe udhëzimet e studimit.

- Pjesëmarrja e grupeve të interesuara, të integrohet në vendimmarrjen mbi menaxhimin e zonës bregdetare.

- Të paktën 5 000 ton mbetje familjare dhe 5 000 ton mbetje ndërtimesh dhe shkatërrimesh, të mblidhen dhe eliminohen në mjedise të përcaktuara dhe të përshtatshme.

- Të paktën 50 % e plazheve publike dhe e zonave të molusqeve përgjatë bregdetit, do t'i monitorohet cilësia e ujit në përputhje me standardet shqiptare dhe direktivat e BE-së.

- Të ketë një rritje të dukshme në shpenzimet e turistëve dhe vizitorëve në bregdetin jugor, gjë që sjell përfitim për komunitete më të gjera.

- Plani i menaxhimit të zonave të mbrojtura për Parkun Kornbëtar të Butrintit, të zhvillohet me pjesëmarrje të gjerë të aktorëve të interesuar dhe rregullat të zbatohen nëpërmjet akteve të duhura nënligjore.

- Përcaktimi i zonave dhe planet e përdorimit të tokës të jenë hartuar dhe përcaktuar për të paktën 3 bashki dhe/ose komuna bregdetare.

- Vlerësimi i ndikimit mbi mjedisin (VNM), të kryhet në përputhje me procedurat e VNM ve dhe me legjislacionin shqiptar, përpara dhënies së lejeve mjedisore dhe fillimit të ndërtimeve dhe aktiviteteve të zhvillimit në zonën bregdetare jugore.

- Planet e zhvillimit vendor të jenë formuluar dhe aprovuar për të paktën 5 komuna që ndodhen në bregdetin e jugut.

- Të jetë arritur reduktimi i ndotjes së dheut në zonat pranë qendrave të populluara në Porto Romano.

7. Kushtet për futjen në fazën e II-të

Kushtet e ecurisë që duhet të plotësohen për të kaluar në fazën e II-të janë:

- Të jetë hartuar, zbatuar e forcuar kuadri ligjor e institucional rregullator për Menaxhimin e Integruar të Zonës Bregdetare në nivel lokal, rajonal e kombëtar.

- Të hartohen plane rajonale dhe lokale të zhvillimit të përdorimit të tokës në zonën bregdetare, në përputhje me kriteret dhe metodologjitë e aprovuara të planifikimit të përdorimit të tokës, që të përfshijnë vlerësimin strategjik mjedisor në procesin e planifikimit, duke zbatuar një mënyrë planifikimi me pjesëmarrje.

- Të bëhet vlerësimi strategjik mjedisor dhe kuadri i shpërnguljes, për të udhëhequr investimet në bregdetin e jugut.

- Të jenë përmirësuar kapacitetet institucionale për zbatimin dhe monitorimin e planeve të përdorimit të tokës, rregulloreve të ndërtimit dhe të vlerësimit të ndikimit mjedisor në zonën e jugut. Rezultatet e monitorimit dhe inspektimit të zbatimit të tyre ligjor të vihen në dispozicion të publikut.

- Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit të tregojë një rritje të përfshirjes së saj në çështje dhe shqetësime mjedisore.

- Veprimtaritë e pastrimit dhe investimeve në infrastrukturën mjedisore të fazës së I-rë, të tregojnë përparim të kënaqshëm (të paktën 70% angazhim dhe 50% disbursim i komponentit B - Infrastruktura dhe Rehabilitimi Mjedisor Bregdetar).

- Të hartohet dhe miratohet nga këshilli bashkiak i Durrësit, plani i përdorimit të tokës për Porto Romanon.

8. Kuadri i trajtimit të çështjeve mjedisore dhe sociale

Qeveria shqiptare është e angazhuar të miratojë dhe aderojë në një paketë procedurash që janë të nevojshme për të integruar sistematikisht çështjet mjedisore dhe sociale, në procesin e zbatimit të programit.

Procedurat duhet të përfshijnë:

1. Adoptimin e Kuadrit të Mbrojtjes Mjedisore dhe Sociale (Environmental and Social Safeguards Framework - ESSF) për të trajtuar çështjet e mjedisit, shitblerjes së tokës, kufizimit të aksesit, si dhe ato të pronësisë kulturore që lidhen me investimet infrastrukturore dhe planin e menaxhimit të zonave të mbrojtura për Parkun e Butrintit, si dhe për investimet e ardhshme që do të ndërmerren në zbatim të studimit në të gjithë zonën bregdetare jugore.

Për sa më sipër, plotësohen kërkesat e legjislacionit shqiptar dhe Politikat e Mbrojtjes Mjedisore dhe Sociale të Bankës Botërore, duke përfshirë kërkesat që lidhen me vlerësimin mjedisor, shpërnguljen e detyruar dhe pronësinë kulturore.

2. Të kryhet Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) për studimin gjatë procesit të hartimit të tij në përputhje me rregullat mjedisore shqiptare dhe politikave të Bankës Botërore.

3. Të bëhet adoptimi i procedurave dhe masave të duhura, përfshirë një kuadër politik të shpërngulies për të gjithë zonën bregdetare jugore, për të shmangur (dhe aty ku nuk është e mundur të shmangen, për të zbutur) rreziqet ndaj individeve dhe komuniteteve në qoftë se studimi dhe përcaktimi i zonave, rregulloret dhe investimet specifike, do të kenë efekte negative në lidhje me humbjen e tokës apo jetesës. Këto procedura do të plotësojnë kërkesat e politikës së Bankës
Botërore mbi shpërnguljen e detyruar.

Në qoftë se do të ketë nevojë që politika e shpërnguljeve të zbatohet për zonat e mbuluara nga studimi, atëherë do të hartohet një plan shpërnguljeje. Në përgjithësi, parimi i kësaj politike është të ndihmojë personat e prekur në përpjekjet e tyre për të përmirësuar dhe risjellë standardin e jetesës së tyre në nivelin që ishte përpara fillimit të zbatimit të programit apo nivelin përpara shpërnguljes.

4. Të bëhet kryerja e vlerësimeve të ndikimit mbi mjedisin (EIAs) më specifik investimet, të cilat plotësojnë kërkesat e legjislacionit shqiptar dhe politikat operative të Bankës Botërore, për çdo investim individual të zbatueshëm në kuadrin e programit.

9. Masat institucionale dhe zbatuese

1. Komiteti Drejtues i Programit (PSC). Qeveria do të krijojë Komitetin Drejtues të Programit, që do të jetë përgjegjes për mbikëqyrjen e përgjithshme të projektit, vlerësimi i progresit dhe asistenca në kapërcimin e vështirësive për zbatimin e tij.

Komiteti do të përfshijë vendimmarrës të nivelit të lartë (në nivel zëvendësministri) nga Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit (kryesia), Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Mjedisit, Ministria e Transporteve dhe Telekomunikacionit dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit, si dhe përfaqësues nga administratat rajonale dhe lokale dhe OJF-të.

2. Njësia e Koordinimit të Programit - Program Coordination Unit (PCU). Koordinimi i përgjithshëm institucional i programit do të bëhet nga Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, si agjencia drejtuese qeveritare e ngarkuar me koordinimin e përgjithshëm të programit.

Do të krijohet një Njësi e Koordinimit të Programit (PCU) brenda strukturës së MRRTT për të marrë përgjegjësinë e koordinimit të projektit, prokurimin, menaxhimin financiar, disbursimet, monitorimin, vlerësimin dhe raportimin, dhe do të jetë në varësinë e zyrtarit autorizues të programit.

3. Zyrtari autorizues i programit - Program Authorizing Official (PAO). PAO do të jetë Zv/Ministri i Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, i cili do të ketë përgjegjësinë e mbikëqyrjes së punës së PCU dhe nënshkrimit të veprimtarive të prokurimit. PAO do t'i raportojë qeverisë, nëpërmjet Komitetit Drejtues të Programit, mbi përparimin e zbatimit të tij.

Veprimtaritë e programit do të zbatohen nga entet ekzistuese në nivel qendror, rajonal dhe lokal.

4. Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit. MRRTT, nëpërrmjet PCU do të jetë përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe mbështetjen e aktiviteteve të kryera nga MRRTT. Në funksion të zbatimit të programit, MRRTT mund të formojë një ekip në rang rajonal për aktivitete të ndryshme të programit.

5. Ministria e Mjedisit do të jetë përgjegjëse për zbatimin e punës rehabilituese të Porto Romanos dhe veprimtaritë e forcimit institucional që lidhen me të.

Do të krijohet një ekip zbatues (MoE - IT) për mbikëqyrjen dhe mbështetjen e të gjitha aspekteve teknike të zbatimit të veprimtarive të projektit që janë nën përgjegjësinë e Ministrisë së Mjedisit.

6. Ministria e Transporteve dhe Telekomunikacionit. Autoriteti i portit të Sarandës do të emërojë një koordinator programi që të jetë përgjegjës për aspektet teknike dhe lehtësimin e zbatimit të veprimtarive që lidhen me punët rehabilituese të portit të Sarandës

Drejtoria e Përgjithshme e Lundrimit Detar në këtë ministri do të jetë përgjegjëse për mbikëqyrjen e këtij procesi.

7. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve, nëpërmjet administratës së Parkut Kombëtar të Butrintit, do të jetë përgjegjëse për zbatimin e veprimtarive të menaxhimit të zonave të mbrojtura dhe për lehtësimin e zbatimit të veprimtarive në kuadrin e pjesës së mbrojtjes mjedisore dhe veprimtarive të qëndrueshme ekonomike.

8. Bashkitë dhe komunat bregdetare. Autoritetet vendore të zonës bregdetare të jugut do të jenë përgjegjëse për lehtësimin e planifikimit dhe zbatimit të veprimtarive të menaxhimit të mbetjeve të ngurta. Komunat dhe bashkitë e zonave bregdetare do të jenë përgjegjëse për planifikimin e implementimin e aktiviteteve të përfshira në projektin e ruajtjes dhe zhvilllimit të fshatit bregdetar.

10. Monitorimi dhe vlerësimi.

Funksioni i monitorimit dhe vlerësimit të programit do të kryhet nga PCU në MRRTT.

PCU do të jetë përgjegjëse për përgatitjen e raporteve menaxhuese tremujore dhe 1-vjeçare, të cilat do t'i dorëzohen Komitetit Drejtues të Projektit, Bankës Botërore dhe bashkëfinancuesve të programit. Vlerësimi i veprimtarive të forcimit institucional, do të bëhet nga konsulentë të pavarur për vlerësimin e rezultateve të programit në lidhje me forcimin e kapaciteteve lokale, në mes të periudhës dhe nga fundi i programit.

Gjithashtu, me përfituesit nga fshatrat e përfshirë në programin e infrastrukturës dhe rehabilitimit mjedisor të bregdetit do të bëhen sondazhe në fillim, në mes dhe në fund të projektit për të vlerësuar ndikimin e programit.